# Mësojmë Shqip
# Μαθαίνουμε Αλβανικά
# II

Libër dhe Ushtrime

Βιβλίο και Ασκήσεις

A2/B1

Συγγραφείς

Αμαλία Ρόντου-Γκόρου
Μαρία Σουκαλοπούλου

Επιστημονική Επιμέλεια

Ανθή Ρεβυθιάδου
Βασίλειος Σπυρόπουλος

ISBN: 978-618-81071-4-4

Ιούνιος 2014

Συγγραφείς: Αμαλία Ρόντου-Γκόρου
Μαρία Σουκαλοπούλου

Επιστημονική Επιμέλεια: Ανθή Ρεβυθιάδου (Αναπληρώτρια Καθηγήτρια, Α.Π.Θ.)
Βασίλειος Σπυρόπουλος (Επίκουρος Καθηγητής, Ε.Κ.Π.Α.)

*Η Πράξη "Εκπαίδευση Αλλοδαπών και Παλιννοστούντων Μαθητών" υλοποιείται μέσω του Επιχειρησιακού Προγράμματος "Εκπαίδευση και Διά Βίου Μάθηση" και συγχρηματοδοτείται από την Ευρωπαϊκή Ένωση (Ευρωπαϊκό Κοινωνικό Ταμείο) και από εθνικούς πόρους.*

Για τη συμβολή τους στη διδασκαλία και ανατροφοδότηση του γλωσσοδιδακτικού υλικού, θα θέλαμε να ευχαριστήσουμε τις κυρίες Άλμα Ζεκολάρι και Μαριάννα Γκίνη.

Ευχαριστούμε θερμά την Αλεξάνδρα Μαυρίδου για την εθελοντική της συνεισφορά στη γραφιστική επεξεργασία του βιβλίου.

Εκδόσεις
Ειδικός Λογαριασμός Κονδυλίων Έρευνας
Αριστοτελείου Πανεπιστημίου Θεσσαλονίκης (Ε.Λ.Κ.Ε. Α.Π.Θ.)
Γ' Σεπτεμβρίου, Κτήριο Κ.Ε.Δ.Ε.Α., Πανεπιστημιούπολη
54124, Θεσσαλονίκη
Τηλ: 2310 991356, Fax: 2310 200392

Άδεια Creative Commons
Αναφορά Δημιουργού – Μη εμπορική χρήση – Όχι Παράγωγα έργα 3.0 Ελλάδα

Επιτρέπεται σε οποιονδήποτε αναγνώστη η αναπαραγωγή του έργου (ολική, μερική ή περιληπτική, με οποιονδήποτε τρόπο, μηχανικό, ηλεκτρονικό, φωτοτυπικό, ηχογράφησης ή άλλο), η διανομή και η παρουσίαση στο κοινό υπό τις ακόλουθες προϋποθέσεις: αναφορά της πηγής προέλευσης, μη εμπορική χρήση του έργου. Επίσης, δεν μπορείτε να αλλοιώσετε, να τροποποιήσετε ή να δημιουργήσετε πάνω στο έργο αυτό.

Αναλυτικές πληροφορίες για τη συγκεκριμένη άδεια cc, μπορείτε να διαβάσετε στην ηλεκτρονική διεύθυνση: http://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/3.0/gr/

# Εισαγωγή στο βιβλίο

Αγαπητά μας παιδιά,

Το βιβλίο αυτό αποτελεί ένα ταξίδι στην αλβανική γλώσσα με οδηγό τη Βαλμπόνα, ένα κορίτσι της ηλικίας σας από την Αλβανία και τους πολλούς της φίλους. Παρέα με τα παιδιά αυτά θα διαβάσετε, θα γράψετε, θα ακούσετε τραγούδια, θα ζωγραφίσετε, θα φτιάξετε κατασκευές και θα παίξετε. Και όλα αυτά θα τα κάνετε στα Αλβανικά!

Το βιβλίο αποτελείται από 10 μαθήματα με διαφορετικά θέματα που αφορούν την καθημερινότητά σας και τον κόσμο γύρω σας. Κάθε μάθημα έχει 6 διαφορετικές δραστηριότητες, τις οποίες θα δουλεύετε στην τάξη μαζί με την καθηγήτρια/τον καθηγητή σας[1] και τους συμμαθητές και τις συμμαθήτριές σας[2]. Περιλαμβάνει επίσης και το εργαστήρι γραμματικής με πίνακες και χρήσιμες πληροφορίες για σημαντικά γραμματικά φαινόμενα της αλβανικής γλώσσας. Στο τέλος του βιβλίου υπάρχουν ασκήσεις, κουίζ, κρυπτόλεξα που θα σας βοηθήσουν να ασκηθείτε περισσότερο και να καταλάβετε καλύτερα την αλβανική γραμματική.

Ελπίζουμε να μάθετε διασκεδάζοντας και να απολαύσετε την εμπειρία.

Të dashur fëmijë,

Ky libër është një udhëtim në gjuhën shqipe me udhërrëfyese Valbonën, një vajzë të moshës tuaj nga Shqipëria dhe shumë nga miqtë e saj. Së bashku me këta fëmijë do të lexoni, do të shkruani, do të dëgjoni këngë, do të vizatoni, do të ndërtoni e do të luani. Dhe të gjitha këto do t'i bëni në gjuhën shqipe!

Teksti përbëhet nga 10 mësime me tema të ndryshme që lidhen me jetën tuaj të përditshme dhe botën rreth jush. Çdo mësim i përgjigjet gjashtë veprimtarive, të cilat do të punoni në klasë me mësuesin/mësuesen dhe shokët/shoqet e klasës. Përfshin gjithashtu edhe laboratorin e gjuhës me tabelat dhe informacionin e duhur mbi rregullat gramatikore të gjuhës shqipe. Në fund të librit ka ushtrime, kuize, lojëra me fjalë të fshehura që do t'ju ndihmojnë të punoni më tepër dhe të kuptoni më mirë gramatikën e gjuhës shqipe.

Shpresojmë të mësoni duke u argëtuar dhe shijuar përvojën.

Autorët e librit

1. Προς αποφυγή επαναλήψεων σημειώνεται ότι η επιλογή της χρήσης του θηλυκού γένους στο υπόλοιπο του εγχειριδίου βασίζεται στο γεγονός ότι η συντριπτική πλειονότητα των καθηγητών/καθηγητριών γλωσσών δευτεροβάθμιας εκπαίδευσης είναι γυναίκες και σε καμία περίπτωση δεν συνιστά προσπάθεια αναπαραγωγής έμφυλων στερεοτύπων.

2. Κατα τον σχεδιασμό αυτού του εγχειριδίου ελήφθη υπόψη η αρχή της ισότητας των φύλων και στο πλαίσιο αυτό χρησιμοποιούνται και τα δυο γενη στην εκφώνηση των ασκήσεων.

# Mësojmë Shqip II


1. Historì verore 1

2. Një herë e një kohë 9

3. Të çuditshme, por të vërteta 19

4. Gëzuar festat! 27

5. Shtëpia ime 33

6. Teknologjia e së ardhmes 42


# Ushtrime


1. Histori verore 53

2. Një herë e një kohë 58

3. Të çuditshme, por të vërteta 65

4. Gëzuar festat! 73

5. Shtëpia ime 79

6. Teknologjia e së ardhmes 84

# RUBRIKAT MËSIMORE



Flasim



Shkruajmë



Lexojmë



Luajmë



Shikojmë film



Zbulojmë



Ndërtojmë



Dëgjojmë



Mësojmë fjalë të reja

# Mësimi 1



**Σε αυτό το μάθημα θα μάθεις:**

Να χρησιμοποιείς τα ρήματα **έχω** και **είμαι** στον παρατατικό.

Να περιγράφεις ενέργειες στο παρελθόν χρησιμοποιώντας ρήματα στον παρατατικό.

Να μιλάς για τα συναισθήματά σου.

Να διερευνάς τις καθημερινές σου συνήθειες και τις συνήθειες των συμμαθητών και των συμμαθητριών σου και να παρουσιάζεις τα αποτελέσματα της έρευνάς σου στην τάξη.

**Në këtë mësim do të mësosh:**

Të përdorësh foljet **kam** dhe **jam** në kohën e pakryer.

Të përshkruash me anë të foljeve në kohën e pakryer veprime që ndodhën në kohën e shkuar.

Të flasësh për ndjenjat e tua.

Të zbulosh shprehitë e tua të përditshme si dhe shprehitë e shokëve/shoqeve dhe në vijim të paraqesësh rezultatet e punës në klasë.

1

Το καλοκαίρι τελείωσε. Πώς πέρασες το καλοκαίρι σου; Μπορείς να κρατήσεις σημειώσεις παρακάτω και να διηγηθείς στην τάξη πώς περνούσες την κάθε σου ημέρα;

Pushimet verore mbaruan. Si i kalove pushimet e tua verore? Çfarë bëre gjatë pushimeve? Mbaj shënime dhe thuaj në klasë se si kalove ditët e pushimeve të tua.



2

Η παρέα επιστρέφει στο σχολείο. Συμπλήρωσε τις προτάσεις που λείπουν, διάβασε το κείμενο και μάθε τι έκανε ο καθένας/η καθεμιά το καλοκαίρι που πέρασε.

Nxënësit rikthehen në shkollë. Plotëso fjalitë që mungojnë më poshtë, lexo tekstin dhe mëso se çfarë bëri secili/secila verën e kaluar.

Fjalitë: (luaja basketboll, shkoja në plazh, ngrihesha herët, ~~**ndihmoja gjyshen dhe gjyshin**~~, notoja orë të tëra)



**Valbona**
Përshëndetje! Si jeni? Si i kaluat pushimet verore?



**Kosta**
Unë kalova shumë bukur. Çdo mëngjes .......... .............dhe shkoja në det. Hanim drekë bashkë me familjen time dhe pasdite luaja me biçikletë me miqtë e mi deri natën vonë. Po, ti Jorgo? Si e kaloje ditën gjatë pushimeve?



**Jorgo**
Zgjohesha herët në mëngjes dhe **ndihmoja gjyshen dhe gjyshin** tim në punët e kopshtit. Ndihmoja nënën të gatuante dhe pasdite ............. ..............ose futboll me fëmijët e tjerë të fshatit. Po ti Valbona çfarë bëre? Shkove si përfundim në Shqipëri tek gjyshi dhe gjyshja?



**Valbona**
Jo, për fat të keq nuk shkova. Qëndrova në Athinë. Lexoja libra, shikoja televizor, luaja me motrën time në park, në fundjavë .......... ..... ................ me prindërit e mi në Korinth. Kaloja tërë ditën në plazh, ............... ......... .. .........., luaja me raketa dhe ktheheshim në Athinë natën vonë. Kalova shumë bukur edhe kështu. Tani të gjitha gjërat e mira mbaruan. Përsëri në shkollë! Si do të jetë vallë sivjet? Por u gëzova shumë që ju pashë përsëri dhe që jemi në të njëjtën klasë.



**Kosta**
Edhe ne u gëzuam Valbona.



**Artani**
Unë jam optimist dhe besoj se edhe sivjet do të jetë një vit i shkëlqyer.

**Ποια/Ποιος έκανε τι; Γράψε το όνομα του κάθε παιδιού δίπλα από την κατάλληλη εικόνα.**

**Cili/cila bëri çfarë? Shkruani emrin e çdo fëmije përbri fotografisë së duhur.**

 . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .  . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .

 . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .  . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .

 . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .  . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . . .

## Laboratori i gjuhës



FOLJA/PHMA

Koha e pakryer e foljes/Παρατατικός

Τα ρήματα που είναι στον παρατατικό μας δείχνουν κάτι που επαναλαμβανόταν ή γινόταν συνεχώς στο παρελθόν.

**Fëmijët luanin futboll gjithë mbasditen.**

Τα παιδιά έπαιζαν ποδόσφαιρο όλο το απόγευμα.

**Kosta hante drekë me famijen e tij.**

Ο Κώστας έτρωγε μεσημεριανό με την οικογένειά του.

Στον πίνακα μπορείς να δεις πώς σχηματίζονται και πώς κλίνονται στον παρατατικό ρήματα και των τριών συζυγιών.

| | **Α συζυγία** | **Β συζυγία** | **Γ συζυγία** |
|---|---|---|---|
| | **banoj** | **zbres** | **rri** |
| Unë | bano-**ja** | zbris-**ja** | rri-**ja** |
| Ti | bano-**je** | zbris-**je** | rri-**je** |
| Ai/ Ajo | bano-**nte** | zbris-**te** | rri-**nte** |
| Ne | bano-**nim** | zbris-**nim** | rri-**nim** |
| Ju | bano-**nit** | zbris-**nit** | rri-**nit** |
| Ata/ Ato | bano-**nin** | zbris-**nin** | rri-**nin** |

**Mohore -**

Valbona **nuk luante** basketboll në oborrin e shkollës.

Valbona **s' luante** basketboll në oborrin e shkollës.

**Pyetëse ?**

Si e **kaloje** ditën gjatë pushimeve verore?

3

Κάθε Σεπτέμβρη η επιστροφή στο σχολείο γεμίζει τα παιδιά με διάφορα συναισθήματα. Θλίψη για τις διακοπές που τελείωσαν, χαρά για τις φίλες και τους φίλους  που συναντούν ξανά, αγωνία για τη νέα σχολική χρονιά. Μπορείς να αντιστοιχίσεις τα συναισθήματα με τις αντίστοιχες καταστάσεις?

Zakonisht muaji shtator dhe rikthimi në bankat shkollore i mbush fëmijët me ndjenja të ndryshme. Ata janë të mërzitur ngaqë pushimet mbaruan, të gëzuar që takohen përsëri me shokët e shoqet, të shqetësuar për vitin e ri shkollor që sapo filloi. Lidh ndjenjat e fëmijëve me situatën përkatëse.



| | |
|---|---|
| Entusiazëm | kur nuk të pëlqejnë mësimet |
| Turp | takon miq të vjetër dhe bën  miq të rinj |
| Lodhje | je nxënës i ri në klasë dhe nuk njeh asnjë |
| Agoni | të ngacmojnë më të mëdhenjtë |
| Gëzim | njeh mësuesen e re |
| Inat | mëson se je në skuadrën e futbollit |
| Mërzitje | sapo mbaron  gjimnastikën |

## Laboratori i gjuhës




FOLJA/PHMA

Zgjedhimi i foljeve kam dhe jam në kohën e pakryer/ Κλίση των ρημάτων **kam** και **jam** στον παρατατικό

Τα ρήματα **kam** και **jam** στον παρατατικό κλίνονται ως εξής:

| | **Το ρήμα kam** | **Το ρήμα jam** |
|---|---|---|
| Unë | kisha | isha |
| Ti | kishe | ishe |
| Ai/ Ajo | kishte | ishte |
| Ne | kishim | ishim |
| Ju | kishit | ishit |
| Ata/ Ato | kishin | ishin |

**Mohore -**

**Nuk kisha** asnjë shok gjatë pushimeve.

**S' kisha** asnjë shok gjatë pushimeve.

**Pyetëse ?**

**Ishit** për pushime në Shqipëri?

4 


Η καθηγήτριά σας θα σου δώσει ένα ερωτηματολόγιο. Συμπλήρωσέ το με ειλικρίνεια, συζήτησέ το στην τάξη και γράψε στον πίνακα τα αποτελέσματα.

Mësuesja do të të japë një pyetësor. Plotësoje atë me sinqeritet, diskuto për të në klasë dhe shkruaj rezultatet në tabelë.

5 

Διάβασε την ιστορία «Shoku im i fëmijërisë» του Sokol Jakova και απάντησε στις ερωτήσεις συζητώντας στην τάξη.

Lexo tregimin «Shoku im i fëmijërisë» të Sokol Jakovës dhe përgjigju pyetjeve në vazhdim.

**Shoku im i fëmijërisë**

Kur isha i vogëi kam pasur shumë shokë. Dhe shokët e fëmijërisë s'harrohen lehtë. Ndaj edhe sot, kur kanë kaluar shumë vjet, ata s'i ndaj nga vetja. Po sidoqoftë, çdo njeri ka shokun e vet më të ngushtë. Unë asokohe dhe tani kam Fatmirin. Ai ishte një djalë i shkurtër, zeshkan, me flokë kaçurrela, sytë i kishte të vegjël, të futur thellë zgavrave, dhe buzët e trasha. Ndaj të gjithë e thërritnin Rrap. Atij s'i mbetej qejfi, madje na dukej se i pëlqente ky emër, i cili u përhap aq shumë në lagje, sa shumë njerëz s'e dinin që Rrapi emrin e vërtetë e kishte Fatmir.

Me Rrapin më lidhnin shumë ngjarje nga fëmijëria. Ne ishim në një klasë, megjithëse ishte më i madh se unë. Kishte mbetur një vit dhe nga kjo kuptohet se nuk shkëlqente në mësime. Mësonte sa për të kaluar. Natyrisht, mua s'më pëlqente fare që Rrapi s'e kishte mendjen fort në mësime. Ia kisha thënë këtë, e merrja shpesh në shtëpi të mësonim bashkë, kujdesesha që të përgatitej sa më mirë, por përpjekjet e mia shkonin kot. Ai mësonte një ditë pastaj ua varte fare mësimeve dhe jepej pas lojës. Për futbollin i qante zemra. Apo s'luante bukur! Rrapi ishte lojtari më i mirë i skuadrës sonë së lagjes. Tani habitem si ai nuk u bë futbollist, por valltar. Po kështu ndodh jo rrallë me ëndrrat e fëmijërisë. Dëshiron të bëhesh aviator, kur hop rritesh e bëhesh mësues ose mjek. Sidoqoftë këto hollësi na largojnë nga tregimi znë për Rrapin, prandaj, le të vazhdojmë më tej.

Edhe atë vit, në klasë të shtatë, ai mezi kaloi rrokapjekthi, si i thonë. Po në vend të mërzitej Rrapi, u mërzita unë. Morëm dëftesat dhe po ktheheshim në shtëpi. Unë vetëm në algjebër kisha nëntë, pastaj të gjitha dhjeta. Kurse Rrapi vetëm në fiskulturë kishte dhjetë, në të gjitha lëndët e tjera gjashta. Ecnim përkrah njëri-tjetrit pa folur. Kisha ngrysur vetullat dhe s'doja të shihja në sy shokun. Ai donte të fliste, por kuptonte se isha i mërzitur.

Më së fundi s'iu durua dhe më tha:

-Tani në pushimet e verës do të nisim kampionatin. Ç'qejf që do të bëjmë: skuadrën këtë vit e kemi top.

-Te topi ma ke mendjen ti, i thashë i zemëruar.

-Shih more atë dëftesë, që ta kanë mbushur ato gjashtat!

-Ama për pesat e gjashtat e mia mërzitesh ti?

-Mërzitem se të kam shok, Rrapi! Edhe shokët dua t'i kem si vetja. Të kam thënë sa herë të mësosh.

-Pse, unë s'të pëlqekam?-Ma ktheu i mbushur me inat. Unë s'qenkam shok që të përshtatem?

-Përderisa merr vetëm pesa e gjashta, kur ke mundësi për më tepër, nuk je. Po ta them me plot gojën, nuk je.

-Ashtu, mirë që ma the. Edi ç'ke ti, ik e gjej shokë më të mirë se unë. Hajt ik e mos u pjekshim më!

Desh t'i flisja, t'i thosha diçka, po ai u largua me vrap. E ndjeva që ishte zëmëruar e mërzitur shumë. E njihja Rrapin: megjithëse ishte çapkën e i sertë, që s'linte dy gurë bashkë, kishte zemër të butë e prekej lehtë. Mos vallë u solla keq me të? Po unë për të mirë e kisha, doja që edhe ai të mësonte e të bëhej nxënës i mbarë. Eh more Rrapi, Rrapi! Sa më shqetësove atë ditë!

U ndamë. Zënkën tonë e morën vesh edhe shokët, megjithëse s'e dinin shkakun. Ata u habitën si ishim prishur ne shokët më të ngushtë dhe u përpoqën të na pajtonin. Po të drejtën as unë as Rrapi nuk afroheshim. Nisën pushimet verore. Kampionati i futbollit, që bëhej në fushën e lagjes, do të fillonte së shpejti. Skuadra jonë kishte ndeshje të fortë që ditën e parë.

1. Si quhet shoku më i mirë i shkrimtarit?

2. Sipas tekstit, çfarë duhet të kemi kujdes dhe çfarë duhet të shmangim në sjelljen tonë ndaj të tjerëve në mënyrë që të mos krijojmë keqkuptime?

3. Një grindje ose një zënkë nuk është shumë e dëshirueshme, por edhe zënkat janë gjëra që ndodhin edhe në shoqëri. Shpjego arsyet që i bënë dy miqtë të grinden.

4. Një zënkë e vogël mund ta prish një shoqëri të fortë?

6

Τι έκανες στις...? Ρώτησε δύο συμμαθητές/συμμαθήτριές σου, συμπλήρωσε τον πίνακα και ανακοίνωσε το πρόγραμμά τους στην τάξη.

Çfarë bëre në...? Pyet shokët/shoqet e klasës, plotëso tabelën dhe paraqit programin e tyre në klasë.

| | **Shoku 1** | **Shoku 2** |
|---|---|---|
| | | |
| 04:00 MD dje | | |
| 06:00 MD dje | | |
| 08:00 MD dje | | |
| 01:00 PD sot | | |
| 07:00 PD sot | | |
| 07:30 PD sot | | |
| 08:00 PD sot | | |

# Mësimi 2



**Σε αυτό το μάθημα:**

Θα διαβάσεις και θα μιλήσεις για διάσημους μύθους και ιστορίες.

Θα μάθεις να χρησιμοποιείς επίθετα που χαρακτηρίζουν τον ήρωα/την ηρωίδα μιας ιστορίας.

Θα μάθεις να σχηματίζεις και να χρησιμοποιείς τον αόριστο ομαλών και ανώμαλων ρημάτων.

Θα μάθεις να γράφεις ιστορίες δουλεύοντας βήμα βήμα.

**Në këtë mësim:**

Do të lexosh dhe do të flasësh për mitet dhe legjendat.

Do të mësosh të përdorësh mbiemra të cilët kararakterizojnë heroin/heroinën e një historie.

Do të mësosh të përdorësh kohën e kryer të thjeshtë të foljeve të rregullta dhe të parregullta.

Do të mësosh të shkruash një histori duke punuar hap pas hapi.

1

Γνωρίζεις κάποια από αυτές τις ιστορίες; Πότε τις διάβαζες; Θυμάσαι κάποια από αυτές;

Di ndonjë nga këto histori? Kur i lexove? Mban mend ndonjë prej tyre?




2

Περήφανο στέκεται πάνω στον ποταμό Μπούνα το αρχαίο Κάστρο της Rozafa.

Για την κατασκευή του κάστρου υπάρχει ένας ωραίος αλλά πικρός μύθος.

Krenare ngrihet mbi Bunën e gjerë e mbi qytetin e Shkodrës kështjella e lashtë e Rozafatit.

Ndërtimi i kësaj kështjelle ka një gojëdhënë të bukur dhe të hidhur.



**Legjenda e Rozafës**

Mjegulla ra mbi lumin e Bunës mbuloi të tërë qytetin dhe mbeti aty tri ditë e tri netë. Pas tri ditësh e tri netësh një erë e lehtë e largoi. Aty majë kodrës tre vëllezër ndërtonin një kështjellë. Por, muri që ndërtonin ditën, u shembej natën… Kalon aty një plak i mirë dhe u thotë:

-Puna e mbarë o tre vëllezër!

-Mbarë paç o plak i mirë, ku e sheh ti të mbarën tonë? Ditën punojmë murin e natën shembet. Ç'të bëjmë që t'i mbajmë muret në këmbë?

Plaku i mirë mendohet e pyet:

-A jeni të martuar, trima?

-Të martuar jemi i thonë ata.

-Nëse doni të qëndrojë kështjella më jepni fjalën që nuk do të bisedoni me asnjë sekretin që do t'ju them unë.

Nesër do të murosni të gjallë në muret e kështjellës gruan që do të sjellë ushqimin. Atëherë muri nuk do të prishet natën.

Kaq tha plaku dhe u zhduk.

Vëllezërit të mërzitur kthehen në shtëpi. Dy vëllezërit nuk e mbajtën fjalën u treguan grave. Vetëm vëllai i vogël nuk i tregoi gruas së vet.

Të nesërmen, si gjithmonë të tre vëllezërit shkuan në punë.... Nëna e djemve e cila nuk dinte gjë i kërkon nuses së madhe t'u shpjerë burrave ushqimin. Nusja e madhe ankohet se është e sëmurë dhe nuk mund të shkojë. I kërkon të dytës e cila i thotë se do të shkojë të takojë prindërit.

I vjen radha nuses së vogël.

-O nusja e vogël, burrat duan bukë, ujë dhe kungullin me verë.

-Po zonja nënë, përgjigjet nusja e vogël, por kam djalin e vogël që po qan. Dy kunatat e mëdha i premtuan se do të kujdeseshin ato për djalin.

Atëherë ajo mori bukën, ujin dhe kungullin me verë, puthi djalin, dhe u nis. Kur arriti tek vendi i punës, përshëndet burrat.

-Puna e mbarë o mjeshtëra!

Vëllezërit kur e panë, ndalën punën. Fytyrat iu zbehën dhe burrit të saj i ra çekani nga dora. Nusja e vogël i thotë:

-Ç'ke ti, im zot?

Kunati i madh i thotë:

-Ti paske lindur në ditë të zezë, moj kunata e vogël. Ne do të murosim të gjallë vajzën që do na sillte sot për të ngrënë, vetëm në këtë mënyrë kështjella do të qëndrojë e nuk do të shembet më.

-Shëndosh ju o tim kunetër, por unë po ju lë një porosi: Kur të më murosni, syrin e djathtë ma lini jashtë që të shikoj tim bir, dorën e djathtë ma lini jashtë që ta ledhatoj, këmbën e djathtë ma lini jashtë që ti përkund djepin, dhe gjirin e djathtë ma lini jashtë që ta mëkoj kur të qajë. Gjiri im u nguroftë, kështjella jonë gjithmonë qëndroftë, djali im trimëroftë, u bëftë mbret e mbretëroftë!

Vëllezërit e morën nusen e vogël dhe e murosën në themel të kështjellës. Muret u ngritën e u lartësuan e nuk u shembën më as natën e as ditën. Por, rrëzë mureve të kështjellës edhe sot e kësaj dite, gurët janë të lagur dhe plot myk nga lotët e gjiri i nuses së vogël që vazhdon të pikojë për birin e saj.

Mund të shkruash ku dhe kur ndodhin këto ngjarje?

..................................................................................................................................................

Cili/a apo cilët/at janë heronjtë e historisë?

..................................................................................................................................................

..................................................................................................................................................

Ka në tekst mbiemra të cilët na përshkruajnë personalitetin e heronjve?

..................................................................................................................................................

..................................................................................................................................................

Ka në tekst zgjidhje të cilat na japin fillimin, vazhdimin dhe fundin e historisë.

..................................................................................................................................................

..................................................................................................................................................

A di në greqisht ndonjë legjendë të ngjashme?

……………………………………………………………………………………………….....

**Laboratori i gjuhës**




FOLJA/PHMA

Koha e kryer e thjeshtë/Αόριστος

Τα ρήματα που είναι στον αόριστο μας δείχνουν τι έγινε για μια στιγμή στο παρελθόν.

**Dje punova shumë**

Χτες δούλεψα πολύ

Στον πίνακα μπορείς να δεις πώς σχηματίζονται και πώς κλίνονται στον αόριστο ρήματα και των τριών συζυγιών.

| | **Α συζυγία** | | **Β συζυγία** | | **Γ συζυγία** |
|---|---|---|---|---|---|
| | **punoj** | **laj** | **marr** | **prek** | **zë** |
| Unë | puno-**va** | la-**va** | mor-**a** | prek-**a** | zur-**a** |
| Ti | puno-**ve** | la-**ve** | mor-**e** | prek-**e** | zur-**e** |
| Ai /Ajo | puno-**i** | la-**u** | mor-**i** | prek-**u** | zur-**i** |
| Ne | punua-**m** | la-**më** | mor-**ëm** | prek-**ëm** | zu-**më** |
| Ju | punua-**t** | la-**të** | mor-**ët** | prek-**ët** | zu-**të** |
| Ata/Ato | punua-**n** | la-**në** | mor-**ën** | prek-**ën** | zu-**në** |

**Mohore -**

Ai nuk i tregoi gruas së vet.

Ai **s'** i **tregoi** gruas së vet.

**Pyetëse ?**

Kë **morën** me vete prindërit?

3

Συμπλήρωσε τον παρακάτω πίνακα με τα επίθετα της παρένθεσης και θα βρεις πολλές λέξεις για να περιγράψεις την ηρωίδα/τον ήρωά σου.

Plotëso tabelën e mëposhtme me mbiemrat në kllapa, mbiemrat e mëposhtëm do të ndihmojnë të përshkruash heroin/heroinën tënd.

Një hero/heroinë mund të jetë.................................



(~~**miqësor**~~/~~**miqësore**~~, i/e dashur, i pashëm/e pashme, i këndshëm/e këndshme, i/e gëzuar, i/e bukur, i/e zemëruar, shpirtmadh, i sjellshëm/e sjellshme, i/e pastër, i/e qetë, i/e denjë, krijues/krijuese, i/e aftë, i/e shkëlqyer, i/e trishtuar, i/e sinqertë, i/e lumtur, i ndershëm/e ndershme, i gatshëm/e gatshme, i përshtatshëm/e përshtatshme, i fuqishëm/e fuqishme, i dobishëm/e dobishme, ~~i/e frikësuar~~, i/e qetë)

| Paraqitje | Personalitet | Emocion |
|---|---|---|
| | **miqësor/miqësore** | |
| | | |
| | | **i/e frikësuar** |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |

4

Με ποια σειρά εμφανίζονται τα παρακάτω στοιχεία στο κείμενο που θα διαβάσει η καθηγήτριά σου; Βάλε τους αριθμούς 1-5 στα αντίστοιχα κουτάκια.

Cila është radha e fjalëve të mëposhtme në tekstin që ju lexoi mësuesja. Shkruani numrat 1 deri 5 në kutitë përkatëse.

Teatri “Skampa” ☐

Xhamia “Mbret” ☐

Ballokumet ☐

Muzeu i Shkollës Normale ☐

Stadiumi “Ruzhdi Bizhuta”. ☐

## Laboratori i gjuhës




FOLJA/PHMA

Koha e kryer e thjeshtë e foljeve të parregullta/Αόριστος ανώμαλων ρημάτων

Ανώμαλα ρήματα που πρέπει να προσέξεις την ορθογραφία τους στον αόριστο.

| Ενεστώτας | Αόριστος | Ενεστώτας | Αόριστος |
|---|---|---|---|
| bëj | **bëra** | mbaj | **mbajta** |
| bërtas | **bërtita** | mbjell | **mbolla** |
| bie | **prura** | ngas | **ngava** |
| dal | **dola** | ngre | **ngrita** |
| di | **dita** | pres | **prita** |
| dua | **desha** | pres | **preva** |
| flas | **fola** | pyes | **pyeta** |
| fle | **fjeta** | rri | **ndenja** |
| godas | **godita** | sjell | **solla** |
| gjej | **gjeta** | shoh | **pashë** |
| hyj | **hyra** | them | **thashë** |
| lë | **lashë** | vë | **vura** |
| luaj | **luajta** | vij | **erdha** |
| marr | **mora** | zë | **zura** |

Τα ρήματα **kam** και **jam** στον αόριστο σχηματίζονται και κλίνονται ως εξής:

| | **Το ρήμα kam** | **Το ρήμα jam** |
|---|---|---|
| Unë | pata | qeshë |
| Ti | pate | qe |
| Ai/ Ajo | pati | qe |
| Ne | patëm | qemë |
| Ju | patët | qetë |
| Ata/ Ato | patën | qemë |

5

Τι έκανες όταν..; Φτιάξτε αστείες προτάσεις με κάρτες που θα σας μοιράσει η καθηγήτριά σας.

Çfarë bëje kur...? Shkruaj fjali qesharake me kartat që do të shpërndajë mësuesja juaj.

ΘΥΜΗΣΟΥ ότι όταν μιλάμε για δύο πράξεις που έγιναν στο παρελθόν και διακόπτουν η μία την άλλη, η πράξη που διακόπτεται είναι σε παρατατικό, ενώ η πράξη που διακόπτει σε αόριστο. Δες το παράδειγμα:

**Siç lexoja revistat në kioskë, erdhi autobusi.**

Καθώς διάβαζα τα περιοδικά στο περίπτερο, ήρθε το λεωφορείο.

6

Φτιάξε κι εσύ το δικό σου παραμύθι. Ακολούθησε τα βήματα, απάντησε στις ερωτήσεις και φτιάξε τη δική σου ιστορία.

Shkruaj dhe ti një përrallë. Ndiq hapat që të jepen, përgjigju pyetjeve të dhëna dhe përralla është gati për t'u lexuar.



Ky/ Kjo …………………….. Është (kafshë/njeri/lule/send). Fol për heroin tënd. Ka familje? Ku banon? Sa vjeç është?

Për ç'arsye heroi yt është i zemëruar? Cili është shkaku?

Tani mund të shkruash historinë.

1. Ku ishte? Çfarë bënte? Si ndihej? Kush ishte me të? Çfarë bënin?

Çfarë ndodhi?

Papritur,

3. Çfarë bëri heroi yt?

4. Përfundo historinë!



# Mësimi 3



**Σε αυτό το μάθημα:**

Θα διαβάσεις και θα μάθεις για μερικά από τα πιο παράξενα ρεκόρ του κόσμου.

Θα μάθεις να σχηματίζεις και να χρησιμοποιείς τα παραθετικά των επιθέτων.

Θα μάθεις να εκφράζεις μια άποψη ή μια προτίμηση και να προσπαθείς να πείσεις τους άλλους γι' αυτήν.

**Në këtë mësim do të mësosh:**

Disa nga rekordet më të çuditshme në botë.

Të formosh shkallët e mbiemrave.

Të shprehësh një mendim apo një preferencë dhe të përpiqesh të bindësh të tjerët për të.

# Mësimi 3

**1**

Παράξενα και όμως αληθινά. Διάβασε τις παρακάτω προτάσεις. Όλες είναι αληθινές εκτός από μία. Μπορείς να την βρεις;

Të çuditshme, por të vërteta. Lexo fjalitë e mëposhtme. Të gjitha janë të vërteta përveç njërës prej tyre. Mund ta gjesh cila është ajo?

1. Ngjyra blu tërheq më tepër mushkonjat.
2. Nëse mbyll gojën dhe hundën nuk mund të murmurisësh.
3. Delfinët flenë me një sy hapur.
4. Mushkonjat pickojnë më shpesh femrat.
5. Truri i oktapodit rritet (zmadhohet) gjatë gjithë jetës së tij.
6. Skifteri mund të rrotullojë kokën e tij $360^{0}$.
7. Temperatura më e madhe $58^{0}$C është regjistruar në Libi në vitin 1922, ndërsa më e ulëta $89.6^{0}$C në Antarktidë në vitin 1983.
8. Pothuajse në çdo gjuhë të botës, fjala mama fillon me m.
9. Gaforet blu kanë gjak blu.
10. Në mëngjes jemi 1 cm më të gjatë se në mbrëmje.

Pa i lexuar përsëri fjalitë çfarë mban mend?

Sa prej fjalive kanë të bëjnë me kafshët?......................................................................................

Cilat kafshë?………………………………………………………………….........…………………..

Cilat nga këto kafshë mund të hash?.............................................................................................

Cilat fluturojnë?..............................................................................................................................

Sa vende të botës përmenden?.......................................................................................................

Cilat janë ?......................................................................................................................................

Cili mendon se është sugjerimi më i çuditshëm?...........................................................................

2

Στο blog της τάξης τους τα παιδιά αποφάσισαν να βάλουν μερικά από τα πιο παράξενα ρεκόρ του κόσμου. Διάβασε τους τίτλους και προσπάθησε να τους αντιστοιχίσεις με την κατάλληλη περιγραφή.

Në blogun e klasës së tyre fëmijët vendosën të japin disa nga rekordet botërore më të çuditshme. Lexo titujt dhe përpiqu t'i lidhësh me përshkrimin e duhur.

| | |
|---|---|
| **Shoqëruesja më e vjetër e nuses** ● | ● Në vitin 1992, Paul Lynch bëri në Londër 124 ulje-ngritje. |
| **Zhytja më e thellë e qenit** ● | ● Victor Mexicans dhe Gabriel Gomez Ramow kanë 98% të trupit të mbuluar me qime. |
| **Mbajtja më e madhe e frymës nën ujë** ● | ● Bennett Flossie ishte 97 vjeçe kur u bë shoqëruese e nuses në një dasmë në Angli në vitin 1999. |
| **Më shumë ulje-ngritje me një gisht** ● | ● Sandy Allen nga SHBA-ja është rreth 2 metra dhe 21 centimetra. |
| **Familja më leshtore** ● | ● Francezi Michel Lotito ushqehet me metal dhe qelq qysh prej vitit 1959. |
| **Gruaja më e gjatë** ● | ● Në vitin 1990, Gul Mohammed nga India ishte vetëm 57 cm. |
| **Dieta më e çuditshme** ● | ● Zhytësi Robert nga SHBA në vitin 1959 qëndroi nën ujë pa marrë frymë 13 minuta dhe 42.5 sekonda. |
| **Njeriu më i shkurtër** ● | ● Folsom Dwane shkonte shpesh për zhytje me qenin e tij Shadow, i cili zhytet deri në 4 metra. Madje është veshur me veshjen e vet të zhytjes! |

Korrigjo gabimin:

1. Gruaja më e gjatë në botë është angleze.

2. Gjellët më të çuditshme janë gjarpërinjtë dhe macet.

3. Ulje-ngritjet me një gisht u bënë nga Gabriel Ramow Gomez.

4. Njeriu më i gjatë në botë është indian.

5. Kafsha që bëri zhytjen më të thellë është aligatori.

6. Në 85 vjetët e saj Bennet Flossie u bë shoqëruese e nuses.

## Laboratori i gjuhës




Shkallët e mbiemrit/Οι βαθμοί του επιθέτου

Shkalla pohore/Θετικός βαθμός:

**Maria është vajzë e bukur.**

Η Μαρία είναι όμορφη κοπέλα.

Shkalla krahasore/Συγκριτικός βαθμός

**Maria është më e bukur nga Nikoleta.**

Η Μαρία είναι πιο όμορφη από την Νικολέτα.

Shkalla sipërore/Υπερθετικός βαθμός

**Maria është shumë e bukur.**

Η Μαρία είναι πολύ όμορφη.

| Θετικός βαθμός | Συγκριτικός βαθμός | Υπερθετικός βαθμός |
|---|---|---|
| i bukur | më i bukur se/nga | shumë i bukur |
| | aq i bukur sa | mjaft i bukur |
| | | tepër i bukur |
| e kuqe | më e kuqe se/nga | shumë e kuqe |
| | aq e kuqe sa | mjaft e kuqe |
| | | tepër e kuqe |
| | më i bukur se/nga | flakë e kuqe |
| leshtor/e | më leshtor/e se/nga | shumë leshtor/e |
| | aq leshtor/e sa | mjaft leshtor/e |
| | | tepër leshtor/e |

3

Αποφάσισες να ξεκινήσεις ένα περίεργο χόμπυ. Παρακάτω θα δεις πέντε διαφορετικές προτάσεις. Φτιάξε τη λίστα με τις τρεις πρώτες επιλογές σου. Σύγκρινε τη λίστα σου μ'αυτήν που έφτιαξαν οι συμμαθήτριες και οι συμμαθητές σου και προσπάθησε να τις/τους πείσεις γιατί η δική σου είναι καλύτερη.

Συμβουλή: Πέρα από τα προσωπικά σου ενδιαφέροντα διάλεξε κάτι που δεν είναι πολύ ακριβό. Μπορείς να το βρεις κοντά στο σπίτι σου, δεν χρειάζεται πάρα πολύ χρόνο.

Vendose të fillosh një hob të pazakontë. Më poshtë do të jepen pesë variante të ndryshme. Bëj një listë me tri zgjedhjet e tua më të preferuara. Krahaso listën tënde me shokët/shoqet e klasës dhe përpiqu t' i bindësh ata pse variantet që zgjodhe ti janë nga më të mirat.

Këshillë: Pavarësisht nga interesat e tua zgjidh diçka që nuk është shumë e shtrenjtë, që është afër shtëpisë tënde dhe nuk ka nevojë për shumë kohë.

Drums, Gjuhë kineze, Modele me fije shkrepsesh, Breakdance / RnB, Graffit





4

Η μάχη των φύλων. Τα αγόρια ή τα κορίτσια είναι περισσότερο:

Lufta e gjinive. Djemtë apo vajzat janë më shumë:

miqësor, i sjellshëm, i paduruar, atletik, i turpshëm, i ndjeshëm, egoist, ambicioz, i pavarur, llafazan, kokëfortë, energjik, indiferent.

Formoni fjali të tilla si:

(Djemtë janë më atletikë sesa vajzat, sepse ata bëjnë më shumë sport)

Μοιράσου τις απόψεις σου με τους συμμαθητές και τις συμμαθήτριές σου.

Ndani mendimet tuaja me shokët e klasës tuaj.

5

Λύσε το μυστήριο… Η καθηγήτριά σου θα σου δώσει κάποιες πληροφορίες. Μπορείς εσύ να συμπληρώσεις τον πίνακα και να λύσεις πρώτος/πρώτη τον γρίφο;

Zgjidh misterin… Mësuesja do t'ju japë informacionin e duhur. Mund të plotësosh tabelën dhe të zgjidhësh i pari/e para enigmën e dhënë?



| Emri | Mosha | Fëmijë | Profesioni |
|---|---|---|---|
| Kristian | | | Roberta |
| Roberta | 60 | | |
| Maria | | 3 | Veterinere |
| Adam | | | |
| Artan | | 0 | |

6

Τι θα προτιμούσες; Γιατί; Μπορείς να διαλέξεις μία από τις παρακάτω περιπτώσεις και να γράψεις τη γνώμη σου;

Çfarë do të preferoje? Pse? Mund të zgjidhësh një nga situatat e mëposhtme dhe të shkruash mendimin tënd?

Χρησιμοποίησε εκφράσεις όπως:

Përdor shprehjet si:

Unë preferoj ... Unë mendoj se është më mirë për të ... Gjithashtu... Për këtë arsye ...

Të jesh shumë i shkurtër apo shumë i gjatë?

.....................................................................................................................................................

.....................................................................................................................................................

.....................................................................................................................................................

Të jesh i pasur e pa shokë apo i varfër me shumë shokë?

.....................................................................................................................................................

.....................................................................................................................................................

.....................................................................................................................................................

Të jetosh në Alaskë apo në Australi?

.....................................................................................................................................................

.....................................................................................................................................................

.....................................................................................................................................................

Të luash futboll apo të hidhesh nga lartësitë?

.....................................................................................................................................................

.....................................................................................................................................................

.....................................................................................................................................................

Gëzuar Festat!



# Mësimi 4



**Σε αυτό το μάθημα:**

Θα πάρεις πληροφορίες για τις μεγάλες γιορτές της Πρωτοχρονιάς και της Άνοιξης.

Θα θυμηθείς πώς σχηματίζεται και πώς χρησιμοποιείται ο μέλλοντας.

Θα γράψεις για το blog του σχολείου σου οδηγίες για την κατασκευή του Guguvere.

Θα διηγηθείς μια φανταστική χριστουγεννιάτικη ιστορία.

**Në këtë mësim do të mësosh:**

Të marrësh informacion për festën e Vitit të Ri dhe Ditën e Verës.

Të kujtosh si formohet dhe si të përdoret koha e ardhme.

Të shkruash në blogun e shkollës udhëzime për të bërë Guguvere.

Të na tregosh një histori fantastike për Krishtlindjet.

**1** 

Κύκλωσε στο ημερολόγιο τις γιορτές που ξέρεις για την Ελλάδα, την Αλβανία ή άλλες χώρες του κόσμου. Τι κάνουμε σε αυτές τις γιορτές;

Rretho në kalendar festat që njeh nga Greqia, Shqipëria dhe vende të tjera të botës. Çfarë festohet në këto festa?

**JANAR**

| D | H | M | M | E | P | SH |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 1 | 2 | 3 | 4 |
| 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 |
| 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 |
| 26 | 27 | 28 | 29 | 30 | 31 | |

**SHKURT**

| D | H | M | M | E | P | SH |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | 1 |
| 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 |
| 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 |
| 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 |
| 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | |

**MARS**

| D | H | M | M | E | P | SH |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | 1 |
| 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 |
| 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 |
| 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 |
| 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 |
| 30 | 31 | | | | | |

**PRILL**

| D | H | M | M | E | P | SH |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 |
| 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 |
| 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 |
| 27 | 28 | 29 | 30 | | | |

**MAJ**

| D | H | M | M | E | P | SH |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 1 | 2 | 3 |
| 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 |
| 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 |
| 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 | 31 |

**QERSHOR**

| D | H | M | M | E | P | SH |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |
| 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 |
| 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 |
| 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 |
| 29 | 30 | | | | | |

**KORRIK**

| D | H | M | M | E | P | SH |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 |
| 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 |
| 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 |
| 27 | 28 | 29 | 30 | 31 | | |

**GUSHT**

| D | H | M | M | E | P | SH |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | 1 | 2 |
| 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 |
| 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 |
| 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 |
| 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 |
| 31 | | | | | | |

**SHTATOR**

| D | H | M | M | E | P | SH |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
| 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 |
| 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 |
| 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 |
| 28 | 29 | 30 | | | | |

**TETOR**

| D | H | M | M | E | P | SH |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 1 | 2 | 3 | 4 |
| 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 |
| 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 |
| 26 | 27 | 28 | 29 | 30 | 31 | |

**NËNTOR**

| D | H | M | M | E | P | SH |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | 1 |
| 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 |
| 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 |
| 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 |
| 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 |
| 30 | | | | | | |

**DHJETOR**

| D | H | M | M | E | P | SH |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
| 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 |
| 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 |
| 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 |
| 28 | 29 | 30 | 31 | | | |

P.sh. Më 31 tetor në Amerikë dhe Britaninë e Madhe festohet Halloween.

............................................................................................................................

............................................................................................................................

............................................................................................................................

............................................................................................................................

## 2

Πόσο καλά γνωρίζεις τα Χριστούγεννα και την Πρωτοχρονιά στον κόσμο;

A e di si festohen Krishtlindjet dhe Viti i Ri në gjithë botën?

**1.** Legjenda e Babagjyshit nga cili vend filloi?
a. Nga Finlanda
b. Nga Turqia
c. Nga Italia

**2.** Në Britaninë e Madhe ku i lë Babagjyshi dhuratat?
a. Në çorape
b. Në kapele
c. Në këpucë

**3.** Tradita e pemës së Krishtlindjeve nga cili vend filloi?
a. Nga Suedia
b. Nga Gjermania
c. Nga Greqia

**4.** Në Finlandë Babagjyshi udhëton me:
a. mjellmë
b. kec
c. dre

**5.** Në Siri dhuratat ndahen sipër:
a. kalit
b. devesë
c. shqiponjës

**6.** Në Greqi për të ndjekur kukudhin (gogolin):
a. hedhin kripë në zjarr
b. hanë hudhër
c. ndezin qirinj

**7.** Në Ukrainë, në qoftë se gjen pëlhurën e merimangës mëngjesin e Krishtlindjeve do të thotë:
a. fat i mirë
b. tersllëk
c. do të bjerë borë

**8.** Dita e parë e Krishtlindjeve është quajtur:
a. ditë dhuratash
b. ditë gjumi
c. ditë ecjeje

**9.** Në Poloni darka e Krishtlindjeve përmban dymbëdhjetë pjata të cilat kanë kryesisht:
a. djathë
b. peshk
c. qumësht

## 3

Την Πρωτοχρονιά οι περισσότεροι/ες από εμάς παίρνουμε αποφάσεις για τη νέα χρονιά. Παρακάτω θα βρεις μερικές από τις πιο συνηθισμένες αποφάσεις. Κύκλωσε αυτές που ταιριάζουν περισσότερο σε εσένα και πες τι θα ήθελες και εσύ να κάνεις με τη νέα χρονιά.

Natën e Vitit të Ri shumica prej nesh marrim vendime për vitin që vjen. Më poshtë do të gjesh disa nga vendimet më të zakonshme. Rretho ato që të përshtaten më mirë dhe na thuaj se çfarë dëshiron të bësh vitin që vjen.

Këtë vit unë....

- Shëndeti: Bëj më shumë gjimnastikë/filloj një sport/ha më pak ëmbëlsira/nuk ha ushqime të gatshme/nuk fle natën vonë

- Koha e lirë: filloj një hob të ri/mësoj një instrument muzikor/pikturoj/nuk shpenzoj orë të tëra në kompjuter

- Shtëpia/Familja: Ndihmoj nënën time për të psonisur/bëj më shumë punë/pastroj dhomën time/nuk shikoj TV me orë të tëra

- Shkolla: lexoj më shumë/jam më i kujdesshëm në klasë/lexoj libra jashtëshkollorë/përdor internetin për informacion dhe jo vetëm për argëtim

4 

Διάβασε το κείμενο από μια σχολική εφημερίδα των Τιράνων και πάρε πληροφορίες για την ανοιξιάτικη γιορτή Dita e Verës.

Lexo tekstin e marrë nga një gazetë shkollore në Tiranë dhe merr informacion në lidhje me festën e Ditës së Verës.



Dita e Verës ekziston që atëherë kur njerëzit u faleshim ende perëndive.

Këtë ditë i urojmë mirëseardhjen stinës së pranverës. Mos ju ngatërrova pak? Ju thashë që është «Dita e Verës», kur në fakt është pranverë. Thuhet se kur lindi kjo festë njerëzit njihnin vetëm dy stinë: dimrin dhe verën, prandaj festa quhet «Dita e Verës». Kjo ishte edhe dita e parë e vitit sipas kalendarit të lashtë të shqiptarëve.

Kur themi «Dita e Verës», mendja na shkon te qyteti i Elbasanit. Me kalimin e kohës, në shumë qytete kjo festë erdhi duke u zbehur, por në Elbasan vazhdon ruhet edhe sot e kësaj dite, ndjehet dhe të përjetohet në kuptimin e plotë të fjalës... I tërë qyteti zbukurohet, organizohen koncerte, mbillen pemë të reja, ndahen ballokume dhe në shëtitoret e qytetit sheh njerëz nga shumë qytete të Shqipërisë.

Thuhet se dikur, në rrethinat e qytetit të lashtë të Elbasanit jetonte Zana e Çermenikës, e cila ishte perëndesha e gjuetisë, pyjeve dhe e gjithë natyrës. Sipas gojëdhënës, kjo zanë dilte nga tempulli i saj ditën e 14 Marsit. Prandaj kremtohet në këtë datë «Dita e Verës».

Të parët tregojnë se një natë para Ditës së Verës, njerëzit mblidheshin më shpejt në shtëpitë e tyre, për të festuar së bashku me të afërmit epilogun e kësaj feste. Shtëpia mbushej plot me gjëra të mira. Porta zbukurohej me lule dhe lastarë të gjelbër, të cilët simbolizojnë mirësinë dhe natyrën. Në datën 13 merret një tufë e vogël bari të njomë bashkë me rrënjët dhe dheun, që në mëngjesin e datës 14 Mars të jetë në shtëpi, pasi mendohet se sjell fat.

Natën e 13 marsit ndizen zjarre; çdo shtëpi e qytetit mbushet me një gëzim të veçantë. Të afërmit e miqtë këndojnë këngë të vjetra dhe shijojnë kuzhinën elbasanase.

Mëngjesi i 14 marsit nis me vizitat tek të afërmit.

Pikniku nis në orën 10:00. Në piknikun e Ditës së Verës elbasanasit lënë qytetin dhe u drejtohen pikave turistike.

Αφού διαβάσεις το κείμενο, γίνε δημοσιογράφος και πάρε συνέντευξη από μια μαθήτρια/έναν μαθητή γυμνασίου για την ημέρα της Άνοιξης.

Pasi të lexosh tekstin bëhu dhe ti gazetar. Merr në intervistë një nxënës/nxënëse të shkollës së mesme për Ditën e Verës.



5

Γράψε για το blog του σχολείου σου οδηγίες για την κατασκευή του Guguvere  ή Verore. Οι παρακάτω λέξεις θα σε βοηθήσουν:

Shkruaj në blogun e klasës tënde udhëzime për thurjen e Guguveres ose siç quhet ndryshe Verores. Fjalët e mëposhtme do të ndihmojnë:

(fije të kuqe/të bardha, thurr, rruazë bojë qielli, dallëndyshe, syri i keq, lidh, dorë, djeg, diell, byrzylyk mbaj, hedh, pemë, fole)

6

Τα Χριστούγεννα συνδέονται με χιλιάδες ιστορίες και παραδόσεις σε όλο τον κόσμο. Γράψε κι εσύ την συνέχεια της παρακάτω ιστορίας βάζοντας τη φαντασία σου...

Festa e Krishtlindjeve është lidhur me mijëra histori e rite në të gjithë botën. Shkruaj me fantazi vazhdimin e historisë.

Valbona tek po flinte dëgjoi një zhurmë të fortë. Me hapa të lehtë dalëngadalë vajti në sallon kur...

# Mësimi 5

**Σε αυτό το μάθημα:**

Θα μάθεις λεξιλόγιο σχετικά με το σπίτι και τους χώρους του σπιτιού.

Θα ψάξεις σε αγγελίες εφημερίδων και θα γράψεις τις δικές σου αγγελίες για ένα ανταλλακτικό παζάρι.

Θα μάθεις να σχηματίζεις και να χρησιμοποιείς τον ενεστώτα της παθητικής φωνής των ρημάτων.

Θα γίνεις ποιητής/ποιήτρια και θα γράψεις ένα ποίημα για το σπίτι σου.

**Në këtë mësim do të mësosh:**

Të përdorësh fjalor në lidhje me mjedisin shtëpiak.

Të kërkosh në reklamat e gazetave dhe të shkruash reklamën tënde për një pazar.

Do të mësosh të formosh dhe të përdorësh kohën e tashme të formës joveprore të foljeve.

Do të bëhesh poet/poete dhe do të shkruash një vjershë për shtëpinë tënde.

1

A. Σε διάφορες γλώσσες υπάρχουν εκφράσεις όπως αυτές που ακολουθούν: “home sweet home”, «σπίτι μου σπιτάκι μου φτωχοκαλυβάκι μου», “On est bien chez le roi, mais on est mieux chez soi”, “A casa sua ognuno è re”. Σε τι αναφέρονται αυτές οι εκφράσεις; Μπορείς να φανταστείς τι σημαίνουν;

Në gjuhë të ndryshme përdorin shprehjet e mëposhtme: “home sweet home”, «σπίτι μου σπιτάκι μου φτωχοκαλυβάκι μου», “On est bien chez le roi, mais on est mieux chez soi”, “A casa sua ognuno è re”. Mund të thuash kur i përdorim këto shprehje dhe çfarë kuptojmë me to?

B. Δες στις φωτογραφίες μερικά από τα πιο περίεργα σπίτια στον κόσμο. Ποιο σου αρέσει περισσότερο; Τι σου αρέσει και τι δεν σου αρέσει στο καθένα από αυτά; Σε ποιο θα ήθελες να μένεις;

Shih fotot e disa prej shtëpive më të çuditshme në botë. Cila të pëlqen më shumë? Çfarë të pëlqen dhe çfarë nuk të pëlqen në lidhje me secilën prej tyre? Në cilën shtëpi do të pëlqente të banoje ?


Shtëpia luleshtrydhe në Tokio, Japoni


Shtëpia e përmbysur në Poloni


Boeing 727 në Misisipi, SHBA


Shtëpia e lëvizshme në Kopenhagen, Danimarkë.







Πώς είναι το δικό σου σπίτι;

Si është shtëpia jote?



| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| G | H | I | J | B | C | S | U | M | P | E | E | I | R | O |
| X | H | S | H | A | S | H | T | R | A | T | P | L | T | R |
| A | E | K | O | L | L | T | U | K | N | P | T | J | G | I |
| K | U | Z | H | I | N | E | M | I | T | R | V | H | S | A |
| A | X | H | S | H | R | P | L | L | T | S | M | I | T | R |
| P | Q | B | R | D | R | I | T | A | R | E | O | I | B | A |
| A | S | H | X | H | T | P | U | V | R | I | I | I | A | O |
| B | H | S | T | R | Y | E | Z | A | I | O | O | A | N | I |
| T | S | H | J | V | M | L | K | M | O | B | I | L | J | E |
| O | P | T | R | R | S | G | H | A | J | K | P | K | A | L |
| I | I | T | E | L | E | F | O | N | I | S | H | V | X | H |
| I | O | R | T | S | H | G | V | I | M | R | T | G | U | A |

**Laboratori i gjuhës**




FOLJA/PHMA

Forma joveprore/Παθητική φωνή

Τα ρήματα στην παθητική φωνή του ενεστώτα παίρνουν τις καταλήξεις:
-(h)em, -(h)esh, -(h)et, -(h)emi, -(h)eni, -(h)en.

Στον πίνακα μπορείς να δεις πώς κλίνονται τα ρήματα και των τριών συζυγιών στην παθητική φωνή του ενεστώτα σε σχέση με την ενεργητική.

| **Ενεστώτας** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Α συζυγία** | | **Β συζυγία** | | **Γ συζυγία** | |
| **Ενεργητική** | **Παθητική** | **Ενεργητική** | **Παθητική** | **Ενεργητική** | **Παθητική** |
| laj | la**hem** | mbledh | mblidh**em** | vë | vi**hem** |
| lan | la**hesh** | mbledh | mblidh**esh** | vë | vi**hesh** |
| lan | la**het** | mbledh | mblidh**et** | vë | vi**het** |
| lajmë | la**hemi** | mbledhim | mblidh**emi** | vëmë | vi**hemi** |
| lani | la**heni** | mblidhni | mblidh**eni** | vini | vi**heni** |
| lajnë | la**hen** | mbledhin | mblidh**en** | vënë | vi**hen** |

**Mohore -**

Porta **nuk /s'zbukurohet** me lule dhe lastarë të gjelbër.

**Pyetëse ?**

Ku **mblidhen** zakonisht ata?

3  

Οι γονείς της Βαλμπόνα θέλουν να μετακομίσουν. Η Βαλμπόνα ρίχνει μια ματιά στις μικρές αγγελίες στην εφημερίδα. Κοιτάζει για σπίτια και όχι μόνο...

Prindërit e Valbonës duan të transferohen. Valbona i hedh një sy njoftimeve në gazetë. Shikon jo vetëm për shtëpi por edhe për...



Jepet me qera, apartament në katin përdhes, 80m$^2$, pranë metrosë. 2 dhoma gjumi, sallon, kuzhinë, banjo. Çmimi: 280 Euro, pa shpenzime të tepërta.
Tel: 6555555555

Jepet me qera, apartament në katin përdhes, 80m$^2$, pranë metrosë. 2 dhoma gjumi, sallon, kuzhinë, banjo. Çmimi: 280 Euro, pa shpenzime të tepërta.
Tel: 6555555555

Jepet me qera, apartament në katin e parë, 120m$^2$, i mobiluar, 3 dhoma gjumi, sallon, kuzhinë, banjo, veranda të mëdha dhe vend parkimi.
Çmimi: 300 Euro.
Tel: 6986789043

Shitet në Marathonë shtëpi përdhese, afër detit, me oborr të madh. Çmimi është i diskutueshëm. Për më shumë: www.agenreal.com

Përshkrimi i ofertës:
Kërkohet një vajzë për t'u kujdesur për një qenush të vogël në muajin Qershor. Për më shumë informacion komunikoni me zonjën Maria në numrin e telefonit: 6743457447

Bëhen mësime kitare të nivelit fillestar dhe të përparuar. Eksperiencë 10-të vjeçare në këtë fushë. Zonja. Nikoleta: 6565434578

Dhurohen libra për fëmijë. Për më tepër informacion telefono në celular: 674444544

Shitet tigan i përshtatshëm për pop korn! Vetëm 10 euro! Informacion: 6457801284

Cilat njoftime kanë të bëjnë me shitje, blerje apo dhënie shtëpish me qera?

Cili apartament mendon se është më i përshtatshëm për familjen e Valbonës?

Në tabelën e mëposhtme mund të mbash shënime të cilat do të të ndihmojnë:

| Pyetje | Apartamenti 1 | Apartamenti 2 | Apartamenti 3 |
|---|---|---|---|
| Në cilin kat ndodhet apartamenti? | | | |
| Sa kushton qeraja? | | | |
| Sa dhoma ka? Sa e madhe është? | | | |
| Në qeranë mujore përfshihet dhe tarifa e administrimit? | | | |
| Lejohen kafshët shtëpiake? | | | |
| Është afër ndonjë stacioni autobusi apo metroje? | | | |
| Ka vend parkimi? | | | |

Shënim: Familja e Valbonës ka katër pjestarë, një qen dhe nuk kanë makinë.

Njoftimet e tjera...

Për çfarë bëhet fjalë në njoftimin nr.6?

Çfarë kërkojnë në njoftimin nr.5?

Ku ndodhet shtëpia e njoftimit nr.4?

Sa kushtojnë librat e njoftimit nr.7?



4 

Στο σχολείο σας οργανώνετε ένα ανταλλακτικό παζάρι. Ο καθένας/Η καθεμιά φέρνει παιχνίδια, μικρές ηλεκτρικές συσκευές, ρούχα, βιβλία ή ό,τι δεν του/της είναι χρήσιμο πια και το ανταλλάσσει με κάτι που έχει φέρει κάποιος συμμαθητής/συμμαθήτριά του. Φτιάξε την αγγελία που θα βάλεις στην εφημερίδα του σχολείου για να πείσεις τους συμμαθητές και τις συμμαθήτριές σου να επιλέξουν τα δικά σου αντικείμενα. Μπορείς να ανταλλάξεις μέχρι 5 αντικείμενα.

